



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTREVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jedinita Org.Unit	ARPL
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	-01-
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	5377-2/24
Data Datum Date	28.01.25
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	27.12.2024
REFERENC-Ë:	5377/24 - ZSP- 2024
PËR/ZA/TO:	„MA.CON” Fsh . Cërrcë, K. ISTOG
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, U.D. Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së; Z. Agron SHALA, U.D, Drejtor i ARPL-së; Znj. Makfirete DIBRANI, Udhëheqëse e DMRU-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të drejtën ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim – Leje Ujore

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin tekniko-investiv, për shfrytëzim të ujit, me Nr. të protokollit: 5377/24, parashtruar nga „MA.CON” Fsh. Cërrcë dhe ka vendosur si në Vendim për Leje Ujore, të bashkangjitur kësaj shkresë përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

LU

Datë: 27.12.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ, MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e palës „MA.CON” për shfrytëzimin e ujit nëntokësor nga Pusi, për betonjeren, me nr protokoli 5377/24, datë 22.08.2024, Fsh. Cerrcë, K. ISTOG për betonjerë, sipas kushteve vijuese:

1. Sasia maksimale për shfrytëzim e ujit nëntokësorë nga pusi është $Q_{max} = 1.5625$ l/s (dy pikë nëntë litra për sekond), sipas Dokumentacionit të dorëzuar Tekniko – Investiv, në parcelen kadastrale, P-70806057- 00324-2; Fsh. Cerrcë, K. ISTOG, nga Pusi me koordinata: (X=7 455 653,08; Y= 4 737 616,24);
2. Pala përmes regjistrimit me anën e ujëmatësit, duhet të evidentoj: Prurjen mesatare ditore (l/s), sasinë ditore (m^3 /ditë), dhe sasinë vjetore (m^3 /vit);
3. Për sasitë e shfrytëzuara pala obligohet, që për çdo gjashtë muaj, të informoj me shkrim ARPL/MMPHI, nga momenti i marrjes së lejes ujore;



4. Nr. Serik i ujëmatësit, duhet prezantuar në MMPHI në ARPL/MMPHI, brënda 15 dite dhe i njëjti nuk mund te ndryshohet, për ndërrimin e mundshëm të tijë duhet informuar Organi përgjegjës që e ka lëshuar këtë vendim;
5. Obligimi për kompensimin e ujit të shfrytëzuar, do të përcaktohet me aktvendim të posaçëm nga MMPHI, sipas Udhëzimit Administrativ në fuqi, për Strukturën e Pagesave të Ujit;
6. Për këtë pala obligohet të raportoj shfrytëzimin, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbi sasinë e shfrytëzuar të ujit të matur përmes Ujëmatësit, ashtu që të plotësohet kushti paraprak;
7. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (Pesë) vite, me mundësi vazhdimi sipas kërkesës së palës;
8. Për vazhdimin e kohëzgjatjes së Lejes Ujore, bartësi është i obliguar që 2 (dy) muaj para skadimit të afatit, të paraqes kërkesë për vazhdimin të lejes ujore;
9. Në rast se pala vendos, lidhur me rritjen apo zvogëlimin e shfrytëzimit, duhet të bëjë kërkesë për ndryshim të lejes ujore;
10. Leja ujore nuk mund të bartet tek personat e tretë, pa informimin e organit kompetent që e ka lëshuar të njëjtën;
11. Validiteti i Lejes Ujore pushon, në rast të mos plotësimit të kushteve të kërkuara më sipër.

ARSYETIM

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim: “Elaborat për shfrytëzimin e ujërave nëntoksor nga pusi për rritjen e kapacitetit të prodhimit të Betonit” dhe dokumenti investivo teknik për shfrytëzimin e ujit nga Pusi për bazën e betonit: Autorizim për kompaninë hartuese “VE ING”; Certifikata e Regjistrimit të Biznesit; (810297657); Kopje plani për ngastren P-70806057- 00324-2; Certifikata e Pronësisë P-70806057- 00324-2; Pëlqimin mjedisor , me nr protok. Nr. 21/5085/1 - ZSP- /21, datë, 09.12.2021; Leja Ujore, për objektin e ri është , me Nr. 5735/21 – ZSP—2022, datë 27.12.2022; Plani situacionit në përpjesë të lexueshme 1:1000 , hartuar, vulosur dhe nënshkruar nga persni licencuar i lemise perkatëse , ashtu siq kërkohet me “U.Ad. MMPH, 03/2018” ; Certifikata e regjistrimit të biznesit të kompanisë hartuese (811898602);, Diploma e hartuesit të projektit, Z Veton Liman Elshani; Diplome e Esat Bislim Mehani; Pagesat për aplikim nr. 000200; nr. 000198; nr. 196; CD-në



Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE :

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në iniciimin e procedurës së Kontestit administrativ, në Gjykatën Kompetente të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 5377/23 - ZSP- 2024, datë: 27.12.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Istog;
- Arkivit të Ministrisë.

U.D. Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së;



Izedin BYTYQI